



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ prot.

Lezhe, më _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës- PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rehabilitimi i Rrugeve Urbane ne Bashkine Lezhe”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45210000-2.

VLERA E FONDIT LIMIT: 330,563,639.91 (treqind e tridhjetë milion e pesëqind e gjashtedhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nente pike nentedhjetë e një) Lek pa Tvsh.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit (Shtojcat).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe kerkohet nje operator ekonomik i cili te kete minimumin e kerkuar duke marre ne konsiderate objektin e kontrates.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë bazuar ne ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Sa me sipër, Njesia e Prokurimit duke mbajtur ne konsiderate parashikimet ligjore te sipercituara, vendosi qe te kerkoje bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024.

2.2.3 Operoret Ekonomike ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2025.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet

te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesi dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likjuar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorët Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Faturat tatimore te deklaruar ne organet tatimore;
5. Aktin e kolaudimit;
6. Çertifikatë e marrje në dorezim/ Çertifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim.

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipermarrje;
2. Leje Ndertimi;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Fatura tatimore te deklaruar ne organet Tatimore;
5. Akt kolaudimi objekti;
6. Çertifikatë e marrje në dorezim/ Çertifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP-1 A Punime gërmimi në tokë.

NP-4 E Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.

NP-12 A Punime të inxhinierisë mjedisore

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

NS-18 A Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturs dhe Energjië, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton *"Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane."*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve në preventivin e hartuar nga projektuesi pasi aktivitetet kryesore që do të bëjë Kontraktori për perfundimin me sukses të punimeve sipas kontratës në këtë objekt janë:

- Mobilizimi
- Furnizimi, Transporti dhe Magazinimi i Materialeve
- Aktivitetet e Punimeve Ndërtimore
- Mbrojtja e Punimeve, ambientit dhe publikut
- Kontrolli laboratorik, Testimi dhe Kontrolli i cilësive të materialeve

Klasat janë përcaktuar referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008, në proporcion me preventivin e punimeve dhe fondin limit dhe janë analizuar në tabelën e mëposhtme:

Kategoria e Licenses	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Vlera e punimeve në preventiv, sipas kategorisë përkatëse
NP-1 A Punime gërmimi në tokë.	Në preventiv parashikohen punime gërmimi dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet, si dhe me ekskavator zingjir 1.0 m ³ .	0-20,000,000 leke

NP-4 E Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.	Ne preventiv parashikohen punime per rehabilitimin e rrugeve si me poshte: <table><tr><td>Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri</td></tr><tr><td>Shtrese stabilizant t=15cm</td></tr><tr><td>Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri</td></tr><tr><td>Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri</td></tr><tr><td>Shtrese stabilizant t=10cm, per bankina</td></tr><tr><td>Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni</td></tr><tr><td>Struktura monolite betoni C 25/30</td></tr><tr><td>Struktura monolite betoni C 12/15</td></tr><tr><td>F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm</td></tr><tr><td>F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm</td></tr><tr><td>Shtrese zhavor lumi t=15cm</td></tr><tr><td>Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri</td></tr><tr><td>H / Izolim me emulsion, 2 duar bitum</td></tr></table>	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	Shtrese stabilizant t=15cm	Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri	Shtrese stabilizant t=10cm, per bankina	Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni	Struktura monolite betoni C 25/30	Struktura monolite betoni C 12/15	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm	Shtrese zhavor lumi t=15cm	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	H / Izolim me emulsion, 2 duar bitum	330,563,639.91 leke
Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri															
Shtrese stabilizant t=15cm															
Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri															
Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri															
Shtrese stabilizant t=10cm, per bankina															
Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni															
Struktura monolite betoni C 25/30															
Struktura monolite betoni C 12/15															
F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm															
F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm															
Shtrese zhavor lumi t=15cm															
Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri															
H / Izolim me emulsion, 2 duar bitum															
NP-12 A Punime të inxhinierisë mjedisore	Ne lidhje me kërkesën per disponueshmerine e kategorise se pikes NP-12, te licences dhe nivelit te klasifikimit "A", Njesia ka marre ne konsiderat dhe thekson se referuar kompleksitetit te kontrates, Zbatuesi i Punimeve eshte ngarkuar me detyrime te përgjithshme ne kujdesin per mjedisin. <i>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor</i>, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Sipërmarresi, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjithë veprimet e mundshme per te siguruar qe ambjenti lokal i sheshit te ruhet dhe qe linjat e ujit, toka dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera. Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Mbikqyresi i Punimeve, mund te coje ne nderprerjen e kontrates.	0-20,000,000 leke													

NS-18 A Punime topogjeodezike.	Referuar raportit topografik, raportit teknik dhe specifikimeve teknike zbatuesi i punimeve eshte i ngarkuar per kryerjen e punimeve per piketimin e trupit te rruges dhe nxjerrjen e kuotave. Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh. Po ashtu referuar raportit topografik projektuesi ka theksuar se: <i>“Punimet topogjeodezike do të mbështeten në shkallën e plotë të përgatitjes profesionale, në përdorimin e teknologjive bashkëkohore për matjet fushore dhe përpunimin kompjuterik të të dhënave, për të plotësuar kërkesat teknike të parashtruara nga projektuesit. Çdo pike e matur në terren ka koordinata tre dimensionale, të paraqitura në projekt”.</i>	0-20,000,000 leke
---------------------------------------	---	--------------------------

I. Ne lidhje me kërkesën per disponueshmerine e kategorie se pikes NP-12, te licences dhe nivelit te klasifikimit "A", Njesia ka marre ne konsiderat dhe thekson se referuar kompleksitetit te kontrates, Zbatuesi i Punimeve eshte ngarkuar me detyrime te pergjithshme ne kujdesin per mjedisin.

N.P. 12 "Punime të inxhinierisë mjedisore", **Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rristurime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor**, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.

Ndikimet e mundshme gjatë fazës së punimeve

Sistemi i ujrave sipërfaqesore pritët të pësojë ndikim gjatë fazës së ndërtimit si rezultat i punimeve me germime, nga mbetjet inerte, si dhe nga përdorimi i makinerive të rënda ose nga derdhja aksidentale e lubrifikantëve, vajrave, naftës etj.

Bazuar ne kete tip projekti mbetjet nga ndërtimi jane te konsiderueshme duke marre parasyh se kemi te bejme me rehabilitim rruges.

Ndikime te tjera mund te jenë dhe sintetike, të vajrave lubrifikante dhe te materialeve te ndertimit, te cilat do te gjenerohen nga punetoret.

Në varesi të tipit të ndotjes do të mund të percaktohet nese dëmi është afatshkruter apo afatgjate dhe per rrjedhoje punimet duhet te kryhen ne prani te nje inxhinieri mjedisi.

Sa i perket klases "A" se kerkuar, theksojme se kjo fushe specifike nuk shprehet ne zera konkret te preventivit, por eshte komplekse dhe gjithepershires ne te gjitha fazat e zbatimit te projektit, nga momenti i marrjes ne dorezim te sheshit te ndertimit deri ne perfundimin e punimeve dhe dorezimin prane AK-se, te sheshit te ndertimit, e per rrjedhoje kjo kerkese eshte ne proporcion me natyren, volumen dhe kompleksitetin e kontrates.

- II. Ne lidhje me me kërkesën per disponueshmerine e kategorise se pikes NS-18, te licences dhe nivelit te klasifikimit, Njesia ka merre ne konsiderate dhe thekson se referuar raportit topografik, raportit teknik dhe specifikimeve teknike te projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit te kontrates, i gjithe piketimi do te kryhet nga Sipermarresi.

Theksojme se kerkesa per kete kategori dhe klase license eshte bere dhe ne perputhje me VKM Nr. 42, date 16.01.2008, “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, ku percaktohet se:

N.S - 18 "Punime topogjeodezike", konsiderohet ***zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.***

Zbatuesi i punimeve do te realizoje punimet topogjeodezike duke u mbështetur në pikat e poligonometrisë dhe të nivelimit gjeometrik do të zhvillohet procesi i matjeve topografike te zonës në të cilën do të zhvillohet projekti.

Per hartimin e relievit do të merren pikat ku terreni ndërron konfiguracion si dhe dendësia e tyre të plotesojë kushtin e parapercaktuar në kërkesat e parashtruar në projekt në bazë të shkallës së rilevimit, me ndihmën e inst. Total station do të bëhet e mundur që zona të mbulohet plotësisht dhe në vende ku nuk është e mundur perdorimi i marrësve GNSS, por përgjithësisht rilevimi i zonës do te kryhet me marrës GNSS për arsye se koha dhe rendimenti i kësaj teknologjie eshte jashtëzakonisht i lartë dhe saktësia e matjeve është e pranueshme për kërkesat e projektit.

Punimet topogjeodezike do të mbështeten në shkallën e plotë të përgatitjes profesionale, në përdorimin e teknologjive bashkëkohore për matjet dhe përpunimin kompjuterik të të dhënave, për të plotësuar kërkesat teknike të parashtruara nga projektuesit. Çdo pike e matur në terren ka koordinata tre dimensionale, të paraqitura në projekt.

Sa i perket klases "A" se kerkuar, theksojme se kjo fushe specifike nuk shprehet ne zera konkret te preventivit, por eshte komplekse dhe gjithepershires ne te gjitha fazat e zbatimit te projektit, nga momenti i marrjes ne dorezim te sheshit te ndertimit deri ne perfundimin e punimeve dhe dorezimin prane AK-se, te sheshit te ndertimit, e per rrjedhoje kjo kerkese eshte ne proporcion me natyren, volumen dhe kompleksitetin e kontrates dhe kategoritë dhe klasat e licencës janë ne proporcion me

raportet teknike, specifikimet teknike objekt i kësaj kontrate si dhe konform përcaktimeve referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008.

2.3.3 Operatorët Ekonomike duhet të kenë një punësim mesatar të paktën 27 (njetzet e tete) personave të siguruar për periudhën Qershor 2025 – Gusht 2025.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;

b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Shenim: Kjo kërkesë permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit të mesipër për numerin minimal të punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumnin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, raportit teknik, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Njesia e Prokurimit mban në konsideratë se afati për dorezimin e listpagesave nga operatorët ekonomik është data 20 e muajit pasardhës dhe për rrjedhojë në datën e shpalljes së kësaj procedure subjektet kanë deklaruar si muaj të fundit listpagesat e muajt gusht 2025.

2.3.4 Operatorët Ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të shoqërisë dhe të figurojë në Licensën e kompanisë si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|----------------|
| a. Inxhinier Ndërtimi | 1 (nje) |
| b. Inxhinier Mjedisi | 1 (nje) |

-Per stafin e mesiperm Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare si dhe të figurojnë ne listepagesat e kompanise se minimalisht per periudhen Qershor 2025 – Gusht 2025.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e ketyre punimeve. Kriteri i mësipërm ne lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, date 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar parashikohet se: “Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.”

Sa më sipër, duke marre parasysh natyren e puneve te objektit te prokurimit, ka perzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, te cilet jane te nevojshem per realizimin e punimeve. Per me teper duke qene se keto punime jane te nje rendesie te vecante dhe ne te njejten kohe konsistojne ne rehabilitim rruges qe mund te shkaktojne edhe nderhyrje mjedisore shikohet e nevojshme qe te kerkohen specialist te fushave inxhinierike si: Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Mjedisit dhe Inxhinier Gjeodet.

Ne lidhje me kerkesen e Drejtuesit Teknik inxhinier ndertimi, njesia prokurimit ka marre ne konsiderate se projekti per rehabilitimin e rrugeve urbane ne territorin e Bashkise Lezhe, ka si qellim kryesor qe te siguroje segment rrugore sipas standarteve ne fushen e transportit rrugor dhe perfshin kryesisht punime ndertimi.

Ne lidhje me me kerkesen e Drejtuesit Teknik inxhinier Mjedisit, Njesia ka marre ne konsiderate dhe thekson se referuar, raportit teknik dhe Specifikimeve teknike te projektit objekt prokurimi, si dhe kompleksitetit te kontrates, Zbatuesi i Punimeve eshte ngarkuar me detyrime te pergjithshme ne kujdesin per mjedisin. Metodat e punes qe duhet te aplikohen nga zbatuesi duhet te synojne ne minimizimin ose nese eshte e mundur ne ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit. Gjithashtu kerkohet qe te

ndermerren me regorozitet masa mbrojtese sa here qe te jete e nevojshme per te minimizuar ose per te ndaluar efektin negativ ne mjedis.

Ndikimet e mundshme gjatë fazës së punimeve

Sistemi i ujrave sipërfaqesore pritet të pësojë ndikim gjatë fazës së ndërtimit si rezultat i punimeve me germime, nga mbetjet inerte, si dhe nga përdorimi i makinerive të rënda ose nga derdhja aksidentale e lubrifikantëve, vajrave, naftës etj.

Bazuar ne kete tip projekti mbetjet nga ndërtimi jane te konsiderueshme duke marre parasyh se kemi te bejme me rehabilitim rruges.

Ndikime te tjera mund te jenë dhe sintetike, të vajrave lubrifikante dhe te materialeve te ndertimit, te cilat do te gjenerohen nga punetorët.

Në varesi te tipit të ndotjes do të mund te percaktohet nese dëmi është afatshkruter apo afatgjate dhe per rrjedhoje punimet duhet te kryhen ne prani te nje inxhinieri mjedisi.

Sa i perket klases "A" se kerkuar, theksojme se kjo fushe specifike nuk shprehet ne zera konkret te preventivit, por eshte komplekse dhe gjithepershires ne te gjitha fazat e zbatimit te projektit, nga momenti i marrjes ne dorezim te sheshit te ndertimit deri ne perfundimin e punimeve dhe dorezimin prane AK-se, te sheshit te ndertimit, e per rrjedhoje kjo kerkese eshte ne proporcion me natyren, volumen dhe kompleksitetin e kontrates.

Ne lidhje me me kerkesen e Drejtuesit Teknik inxhinier Gjeodet, Njesia ka merre ne konsiderate dhe thekson se referuar raportit topografik, raportit teknik dhe specifikimeve teknike te projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit te kontrates, i gjithe piketimi do te kryhet nga Sipermarresi.

Zbatuesi i punimeve do te realizoje punimet topogjeodezike duke u mbështetur në pikat e poligonometrisë dhe të nivelimit gjeometrik do të zhvillohet procesi i matjeve topografike te zonës në të cilën do të zhvillohet projekti.

Per hartimin e relievit do të merren pikat ku terreni ndërron konfiguracion si dhe dendësia e tyre të plotesojë kushtin e parapercaktuar në kërkesat e parashtruar në projekt në bazë të shkallës së rilevimit, me ndihmën e inst. Total station do të bëhet e mundur që zona të mbulohet plotësisht dhe në vende ku nuk është e mundur perdorimi i marrësve GNSS, por përgjithësisht rilevimi i zonës do te kryhet me marrës GNSS për arsye se koha dhe rendimenti i kësaj teknologjie eshte jashtëzakonisht i lartë dhe saktësia e matjeve është e pranueshme për kërkesat e projektit.

Punimet topogjeodezike do të mbështeten në shkallën e plotë të përgatitjes profesionale, në përdorimin e teknologjive bashkëkohore për matjet dhe përpunimin kompjuterik të të dhënave, për të plotësuar kërkesat teknike të parashtruara nga projektuesit. Çdo pike e matur në terren ka koordinata tre dimensionale, të paraqitura në projekt.

Sa me sipër analiza e këtyre të dhënave dhe kontrolli i nevojshëm në të gjithë etapën e punës që kërkohej të realizohej, kërkon minimalisht inxhinierët e kërkuar.

2.3.5 Krahës stafit teknik Operatorët Ekonomikë duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

- Ing. Ndertimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik ndertimi	2 (dy)	Diplome shkolle mesme
- Teknik Gjeometër/Topograf	1 (nje)	Diplome shkolle mesme
- Hekurkthyes	2 (dy)	Çertifikatë/ Dëshmitë profesionale
- Karpentier	2 (dy)	Çertifikatë/ Dëshmitë profesionale
- Punonjës për punime në Rrugë dhe Asfaltim	5 (pese)	Çertifikatë/ Dëshmitë profesionale
- Shofer	6 (gjashtë)	Leje Drejtimi
- Manovrator	6 (gjashtë)	Dëshmi e Aftësisë Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesipër: Kontratën individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolle mesme/ Dëshmitë profesionale/ Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mesipërme si dhe stafi i mesipërme të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor 2025 – Gusht 2025.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/dëshmitë/certifikatat) që nuk është leshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të metejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

Për profesionet si më sipër, operatori ekonomik duhet të plotësojë tabelën si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni i punonjësit në certifikatë/diplomë	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikatës/diplomës	Numri identifikues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT - (Në rast se leshuesi është institucion privat)
1					
2					
.....					

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe tabelës së mesipërme, të cilat duhet të dorëzohen në fazën e ofertimit në SPE. Ndërsa dokumentacioni provues i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjit nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të nderimit” datë 10.09.1998” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Per stafin mbështetës, në lidhje me kualifikimet janë parashikuar nivele si Diplome Universitare, Diplome e shkolles mesme, Çertifikate/ Deshmite profesionale/ Leje Drejtimi /Deshmi e Aftesise Profesionale etj, te cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga institucione shteterore, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar.

Po ashtu profilet e kërkuar dhe numri i tyre, janë kërkuar në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, duke marrë në konsideratë edhe zërat konkretë të preventivit të zbatimit të punimeve, volumit te tyre, Raportit Teknik dhe Specifikimet Teknike, si dhe mjeteve qe duhet te jene ne dispozicion, pasi parashikohen punime te natyres per germimin e dheut, Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km, Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri, Shtrese binderi me granil gur kave 5cm me makineri, Shtrese stabilizant t=10cm, Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri, Nenshtrese zhavori, Struktura monolite betoni C 20/25, F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm, Tombino me tuba betoni etj.

Njesia e Prokurimit thekson se punimet konsistojn ne rehabilitimin e 43 rrugeve te cilat do te kene nevojje per kryerjen e tyre nga Ing. Ndertimi, teknike ndertimi, teknike gjeometer/topograf hekurkthyes, karpentier dhe punonjes ndihmes per shtrimin e asfaltit, shofere dhe manovratore, kjo bazuar edhe ne zerat e preventivit te hartuar nga projektuesi.

Po ashtu, Njesia e Prokurimit thekson se duke marre ne konsiderate mjetet minimale te nevojshme per kryerjen e punimeve eshte perlllogaritur edhe numri i shofereve dhe manovratoreve qe duhen, megjithate ne lidhje me numrin e kerkuar te shoferev dhe manovratoreve njesia e prokurimit ka kerkuar rreth 50% te kerkeses se mjeteve duke lene te hapur mundesine per pjesen tjeter te stafit I cili mund te kontraktohet ne vijim.

Sa me siper me qellim realizimin e punimeve ne perputhje me specifikimet teknike dhe zbatimin me sukse te kontrates si dhe kontrolli i nevojshem ne te gjithe etapat e punes qe kerkohet te realizohet, kerkon miminalisht stafin e kerkuar.

2.3.6 Operatoret Ekonomike duhet te kene ne stafin teknik ose mbeshtetes, te certifikuar te pakten:

2.3.6/a -1 (nje) punonjes te pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, diplome dhe certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Qershor 2025 – Gusht 2025.

2.3.6/b -1 (nje) Punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Qershor 2025 – Gusht 2025.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.7 Operatorët Ekonomike duhet te disponoje mjetet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	5
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	5
3	Kamion me Vinc	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
4	Kamionçine min 3.5 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
5	Autobot Uji	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
6	Eskavator me zinxhir	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
7	Eskavator me goma	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
8	Minieskavator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
9	Fadrome	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
10	Çekiç Pneumatik	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
11	Rrul Vibruës Hekur-Hekur	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
12	Rrul Vibruës Gome-Hekur	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1

13	Asfaltoshtruese	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
14	Grejder	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
15	Makineri Skarifikimi (Freze Asfalti)	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
16	Rimorkiator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
17	Matrapik	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
18	Makineri prerese Asfalti	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
19	Betonierte kantieri	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
20	Aparat topogjeodezik me GPS	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndërsa për mjete të marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronesi/qera ose kontrate bashkepunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të

lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Sasia e mjeteve/makinerve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Njesia e prokurimit thekson se mjetet e transportit nevojiten per transportimin e rreth 24,000 m3 materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km.

Ndersa mjetet e germimit nevojiten per germim me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet, si dhe punimeve te meposhteme:

Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri
Shtrese stabilizant t=15cm
Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri
Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri
Shtrese stabilizant t=10cm, per bankina
Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet
Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni
Struktura monolite betoni C 25/30
Struktura monolite betoni C 12/15
F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm
F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm
Shtrese zhavor lumi t=15cm
Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri
H / Izolim me emulsion, 2 duar bitum

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur me:

- Licence e leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter është vendosur bazuar në Ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, bazuar në Nenin 5 “Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit”, në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe referuar raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, raportit teknik dhe Specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontrates, metodat e punës që duhet të aplikohen nga zbatuesi duhet të synojnë në minimizimin ose nëse është e mundur në ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit dhe duhet të tregojë një kujdes maksimal në transportin e mbetjeve inerte me qëllim mbrojtjen maksimale të mjedisit.

Ndikimet e mundshme gjatë fazës së punimeve

Sistemi i ujrave sipërfaqesore pritet të pësojë ndikim gjatë fazës së ndërtimit si rezultat i punimve me germime, nga mbetjet inerte, si dhe nga përdorimi i makinerive të rënda ose nga derdhja aksidentale e lubrifikantëve, vajrave, naftës etj.

Bazuar në këtë tip projekti mbetjet nga ndërtimi janë të konsiderueshme duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me rehabilitim rrugësh.

Ndikime të tjera mund të jenë dhe sintetike, të vajrave lubrifikante dhe të materialeve të ndërtimit, të cilat do të gjenerohen nga punëtorët.

Në varesi të tipit të ndotjes do të mund të përcaktohet nëse dëmi është afatshkrutë apo afatgjatë dhe për rrjedhojë punimet duhet të kryhen në prani të një inxhinieri mjedisi.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi impiantet si më poshtë vijon:

- a. 1 (një) Impiant prodhimi Inerte
- b. 1 (një) Impiant prodhimi Asfalti
- c. 1 (një) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit të inerteve/asfaltit/betoni, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimit dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që vërteton pronësinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/asfaltit/betoni, është me qira ose kontratë bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qirase/bashkëpunimit. (KVO do të verifikojë nepermjet QKB nëse impianti i prodhimit të inerteve/asfaltit/betoni është i pajisur me license 3.1.B, në rast të kundërt OE do të skualifikohet).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Njesia e Prokurimit thekson se ky kriter vendoset bazuar në zerat e preventivit si dhe punimeve që do të realizohen dhe rendesise se vecante të këtyre materialeve duke qenë se përbejnë pjesën më të konsiderueshme të preventivit të punimeve.

Autoriteti Kontraktues referuar zerave objekt i kontratës që po prokurohet ka kërkuar që impiantet e prodhimit të cilat mund të jenë në pronësi, me qira ose marrëveshje bashkëpunimi të operatorit ekonomik që do të shpallet fitues si një garanci teknike që kontrata do të realizohet brenda afateve dhe në të gjithë kompleksitetin e zerave të punimeve

Po ashtu theksojmë se Autoriteti Kontraktor nuk kërkon asnjë dokumentacion nga subjekte të treta, pasi verifikimi nëse impianti i prodhimit të inerteve/asfaltit/betonit është i pajisur me license 3.1.B

sipas kërkesave ligjore per mbrojtjen e mjedisit, do te behet nepermjet QKB-se ne web www.qkb.gov.al.

2.3.10 Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:

2.3.10/1 Tombino:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/2 Per Hekur:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Njesia e Prokurimit thekson se ky kriter vendoset bazuar ne zerat e preventivit si dhe punimeve qe do te realizohen per mallrat tombino dhe hekur.

Autoriteti Kontraktues referuar zerave objekt i kontrates qe po prokurohet ka kerkuar qe per mallrat e mesiperm te paraqitet kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar

2.3.11 Operatoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Per Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 45001 : 2018**, mbi “Per Sistemin e Menaxhimit te Shëndetit dhe Sigurise në Punë” ose ekuivalentin e e saj,
- **ISO 14001:2015**, mbi “Per Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit” ose ekuivalentin e e saj .
- **ISO 39001:2012** , mbi “Per Sistemin e Menaxhimit të Sigurise ne Trafikun Rrugor” ose ekuivalentin e saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik”. Referuar natyrës se veçantë, vendndodhjes dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë dhe Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia përgjegjëse ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ku janë shprehur qartë kërkesat AK për realizimin e kontratës.

Njesia përgjegjëse në specifikimet teknike argumenton se nuk ka përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT